

Versioni elektronik i ketij libri u krijua nga
<http://www.enverhoxha.ru>



Gjen. Kol. ENVER HOXHA

ENVER HOXHA

BIOGRAFI E SHKURTËR

SHTYPUR NË STABILIMENTIN «RINIA», TIRANË

Në këmbët e malit të Gjërë, majë bregoresh që ndajnë nga Çajupi në një lumë ngrihet qyteti i Gjinokastrës, kryeqendër e Labërisë, me shtëpi të vjetra e rrugë të ngushta prej kalldrëmi, që të japin përshtyjen e një qyteti antik. Së sipërmi, një kështjellë e madhe me mure të trasha të stilit bizantin, dominon qytetin.

Këtu lindi në 16 të vjeshtës së II-të të vitit 1908 udhëheqësi i sotmë i Shqipëris së Re Enver Hoxha.

Historija e popullit Shqiptar nis nga kohrat më të lashta dhe është një histori plot vuajtje dhe peripesira, plot luftra dhe përpjekje të përgjakëshme kundër shkelësve imperialistë të huaj. Si popull i vogël, ay ka që në shumë herë i detyruar të thyhet përpara armiqve më të mëdhenj dhe më të fortë, por asnjë herë s'është përkulur. Ka ruajtur gjithnjë gjuhën dhe zakonet e tij, dashurinë e madhe për vëndin dhe për lirin e tij dhe ka luftuar kurdoherë për t'i mbrojtur dhe për të fituar indipendencën e tij. Okupacioni otoman që filloi pas vdekjes së heroit legjendar Gjergj Kastriotit, më 1467 dhe mori fund në Nëntor të 1912 ë.s. d. m. th. afro 500 vjet, ishte okupacion i rrezikshëm dhe i tmershëm.

Por edhe pas fitorjes së independencës, gjurmat e okupacionit otoman qenë për shumë kohë një plagë e pashëruar për Shqipërinë. Turqija kishte lënë prapa njerëzit e saj, bejlerët dhe feudalët Shqiptarë, që ishin rritur me mentalitetin e Turqisë së vjetër, me zakonet dhe metodat e saj dhe me të gjithë të mirat që u rezervonte regjimi otoman. Për shumë kohë dhe mbas independencës, me gjithë përpjekjet e drejta të popullit t'onë për një Shqipëri Demokratike, udhëheqja e vendit kishte mbetur në duart e asaj klase me tradita oportuniste dhe tradhtarë në dëm të popullit Shqiptar, e asaj klase që sundonte mbi shtypjen, shfrytëzimin dhe injorancën e masave të gjëra të popullit. I këtij tipi ishte sidomos regjimi feudal i Zogut, që me politikën e tij e shpuri vëndin nën okupacionin e imperializmit fashist italian të 7 Prill 1939.

Nën të tilla kondita, gjatë 26 vjet independence formale që gëzoi vëndi i ynë, nuk mundi të bëjë veç se ndryshime fare të vogla në zhvillimin ekonomik, politik dhe kultural të tij nga gjendja ku e kishte lënë më 1912 okupacioni otoman.

Lufta e jonë për mbrojtjen e Atdheut kundra agresorit fashist, lufta e jonë Nacional-Çlirimtare ishte një luftë nga më të vështirat që kishte parë gjer atëhere Shqipëria. Populli Shqiptar duhesh të lëftonte dhe të thyente një robëri të dyfishtë: okupatorin italian dhe

shtypësit e mbrendëshëm të cilët i kishin lidhur interesat e tyre ngushtësisht me okupatorin. Po lufta N.Çl. e popullit Shqiptar i theu të gjitha veshitë dhe triumfoi, pse populli Shqiptar ishte i ndërgjegjshëm për veprën e madhe që ndërmerte dhe pse në krye të tij pati njëri që vunë në shërbim të popullit gjith forcën dhe inteligjencën e tyre, njëri që fituan me luftën dhe veprën e tyre dashurin e popullit, që e bashkuan dhe udhëhoqën popullin me guxim dhe urtësi në valët më të rezikëshme të luftës dhe të revolucionit.

Të flasësh, qoftë dhe fare shkurtër, mbi jetën e udhëheqësit të Shqipërisë në Enver Hoxha, është e pamundur të mos bësh fjalë për luftën heroike të popullit Shqiptar që shkundi errësirën e 5 shekujve, që dërmoi me fuqitë e tij forcat e okupatorëve italianë dhe Gjermanë dhe nxori vëndin e tij në dritën e lirisë dhe të përparimit.

* *

Enver Hoxha rrjeth nga një familje e mesme intelektuale. Gjyshrit e tij që kishin marrë mësimet në shkollat turke, kanë qënë kadilerë dhe kanë ushtruar vazhdimisht funksionin e gjykatsit të paqit në Shqipri, në Maqedoni dhe nëpër teritore të ndryshme të Perandorisë otomane. Si pasuri të trashëguar nga të parët e saj, familja e Enverit kishte vetëm 4 hektarë tokë në fushën e Dropullit dhe shtëpinë e banimit në Gjinokastër.

Shtëpija u dogj më 1913, kur imperialistët e megali-idesë në Athinë okupuan Shqipërinë e Jugës dhe Gjinokastrën. Grekët ishin kundër independencës së porsa shpallur të Shqipërisë dhe nën parullën e Vorio-Epirit dërguan bandat e tyre t'okuponin Shqipërinë e Jugës dhe të digjnin e të masakronin popullatën muhamedane. Qyteti i Gjinokastrës shpëtoi nga djegja nga guximi i xhaxhajt të Enverit, Hysen Hoxhës, Kryetar Bashkije i Gjinokastrës, i cili refuzoi ultimatumin e Komandës Greke për të zbratur qytetin nga popullata.

Që përpara se t'i digjesh shtëpija, familja e Enverit ishte në varfëri. I ati dhe vëllai i tij të shtërnguar ekonomikisht marrin rrugën e mërgimit. Shkojnë n'Amerikë oër të gjetur punë, por edhe atje nuk qëndruan dot më shumë se një vit, nga shkaku se vëllai që kish filluar punën në fabrikën e hekurit të Detrojtit u bë tyberkuloz dhe u detyrua të kthehet bashkë me t'atnë në Shqipëri. Situata këtu ishte akoma m'e vështirë. Shtëpija u qe djegur, i vëllai duhej kuruar, t'ardhura nuk kishin. Në këto kondita të dëshpëruara jetese e kaloi vegjëlinë e tij Enver Hoxha.

Pas okupacionit grek të Gjinokastrës erdhi okupacioni italian që filloi në Vlorë më 1914 dhe pastaj u shtri gjer në kufijtë t'ona me Greqinë. Enveri kishte filluar atëhere mësimet e para në shkollën fillore të Gjinokastrës, më parë vetëm në gjuhën shqip, pastaj

edhe italisht. Ishte 1 sjellshëm, i dashur me shokë. Sido që gjendja e varfër e familjes nuk lejonte, prindërit e Enverit bënë të gjitha sakrificat që të mos e lënë djalin e tyre pa shkollë. Nga shkalla fillore Enveri doli me nota mjaft të mira, u fut në shkollën qytetse të Gjinokastrës, e cila më vonë u transformua në gjysmë lice franceze.

Kur Zogu, pas vrasjes së Avni Rustemit, u detyrua nga lëvizja popullore të shporej jashtë Shqipërisë, fatkeqësisht për një kohë të shkurtër, Enveri akoma i ri u mundua të shkonte me vullnetarët e Bashkimit dhe me shokët e tij më të rritur që shkonin të luftonin merçenarët e Zogut.

Mbaroi me sukses në Gjinokastër liceun. Por gjëndja e vështirë ekonomike e familjes qëndronte gjithnjë si bariere e pa kapërxyeshme për të vazhduar mësimet. Suksesi në mësimet e gjysmë liceut të Gjinokastrës u bë shkak t'i jepet një bursë për në liceun e Korçës, që ishte atëhere një nga shkollat e mesme më të organizuara dhe më të plota të Shqipërisë.

N'atë kohë shumica e profesorve të liceut ishin francezë dhe me tendenca demokratike liberale, kishte në mes tyre dhe me idera më t'avancuara. Liceu vetë kishte një farë independence dhe regjimi i Zogut, akoma i po konsoliduar nuk e kishte dot nën kontrollin e tij të fortë. Në lice, prirjet e Enverit ishin për histori dhe për

literaturën. Ay studjoi mirë literaturën frenge të shekullit XIX-të dhe sidomos historinë e Revolucionit Francez. Enveri mirrte pjesë n'organizimin e grevave me karakter të brendëshme që bëheshin në lice kundër disiplinës dhe rregullave despotike të Ministrisë Arsimit. Ndonse me karakter të theksuar lokal, ishin gjëra këto që ndodhnin rrallë në shkollat e tjera të Shqipërisë. Në një rebelion të konviktorve të liceut kundër kuserive që bëheshin në kuriz të nxënësve, u desh ndërhyrja e xhandërmarisë Zogiste të shtypesh. Enveri me disa shokë u arrestuan dhe u burgosën për disa ditë, u përjashtuan gjith'ashtu nga shkolla për një javë rjesh.

Ishte koha kur në Shqipëri nuk kishte akoma shënja të një lëvizje të organizuar. Lëvizja e Vlorës kishte dështuar. Qeverija e Zogut, që kishte ardhur në fuqi me ndihmën e imperializmit të huaj në Dhjetor 1924, për të forcuar pozitën e saj, dhe me qëllim që të kishte duar të lira për të bërë tregti me fatet e Atdheut, kishte ushtruar që në fillim një terror të fortë kundër grupeve dhe organizatave me tendenca demokratike. Vrau patriotë me radhë, burgosi dhe internoi qindra vetë, u mundua të mbysë ndërgjegjen kombëtare dhe çdo ndjenjë lirie dhe demokracije. Kjo situatë solli një demoralizim n'elementin e lëkundëshëm demokrat që s'kish kockë të rezistonte dhe u desh shumë kohë që nga kjo gjëndje e dëshpëruar të zgjohej ndërgjegja revolucionare e

masave kundër diktaturës feudale fashiste të Zogut.

Ngjarje të liceut të Korçës, ndonse pa shumë rëndësi në historinë e lëvizjeve demokratike të Shqipërisë, janë simptomat e para të kësaj lloji ndërgjegjeje që po mbruhesh në radhët e të rinjve t'anë.

Në momentin kur do të ekzekutohej vendimi i varjes së disa patriotëve që kishin marrë pjesë në lëvizjen e Vlorës Enveri ndodhej në Gjinokastër. Ay me disa shokë të tjerë shkroi në disa mure të qytetit parulla kërcnuese të regjimit. Ay u arrestua, por në mungesë faktesh u la përsëri i lirë.

Enveri e mbaroi liceun e Korçës në 1930 dhe duke pasur përkrahjen e profesorve i u dha bursë për të ndjekur mësimet e larta në Montpellier të Francës. U regjistrua në degën e shkencave natyrore — seksioni i botanikës — ku bëri vetëm një vit. Gjatë qëndrimit të tij në Montpellier ay pati rastin t'i kushtojë një kohë të veçantë edhe zhvillimit të horizontit të tij letrar duke studjuar veprat e shkrimtarve më të përparuar nga ata që kishte kënduar dhe njohur në lice. Regjimi i Zogut i preu bursën dhe ay detyrohet të shkojë në Paris për të gjetur punë që të mund të frekuentonte dhe mësimet. Në zyrat e Humanite-së u njoh me Kryeredaktorin e organit të Partisë Komuniste Frënge, Paul Vaillant Couturier, të cililit i kërkoi të shkruajë në gazetë artikuj mbi gjëndjen në Shqipëri. Vaillant-i pranoi dhe botoi

disa gjëra në gazetë. Në Paris Enveri nuk gjeti dot punë, por u dërguar sekretar i Konsullatës Shqiptare në Bruksel ku regjistroheshet në Universitetin e këtij qyteti në vitin e dytë të Drejtësisë. S'andejmi vashdoi t'i dërgojë artikuj për në gazetë mikut të tij Vaillant Couturier. Artikujt kishin të bënin me situatën e rëndë në Shqipëri, dhe ishin tani më të studjuar, më të pjekur, pse në Bruksel Enverit i vinin mjaft lajme, gazeta dhe komunikata nga Shqipëria. Spiunët e Zogut që nuk mungonin dhe përjashta Atdheut zbuluan dhe raportuan aktivitetin e Enverit, punën e artikujve të tij dhe për këtë shkak ay pushohet nga puna dhe detyrohet të kthehet në Shqipëri.

Por në Shqipëri situata kishte ndryshuar mjaft. Lidhjet e ngushta politike dhe ekonomike i kishin forcuar pozitat regjimit Zogist. Diktatura feudalo-fashiste e Zogut rëndonte më egër tashti mbi masat e gjëra të popullit, mbi patriotët dhe intelektualët me tendenca demokratike. Në vitin 1936 Enver Hoxha duke folur mbi varrin e patriotit Bajo Topulli hedh parrullën e rezistencës dhe të bashkimit. Ay thotë në mes të tjerave: «Ne që e gjetëm këtë Shqipëri të lirë, këtë Shqipëri që na i pregatitët ju me gjakun e zemrës nuk mund të ndjehemi krenarë po qe se nuk do t'i sjellim një përmirësim shoqërisë Shqiptare, që ju e deshët aq fort. Ju bëte sa mundët, por ne gjatë këtyre 25 vjetëve s'kemi bërë aq sa duhet, por djalërija që po mëkëmbet u zotohet mbi

këtë varr, që është faltorja m'e shenjtë e çdo shqiptari, se nuk do t'i mungojë as vullneti dhe as kurajoja, kur ka për t'ardhur puna, që të përgatiti një Shqipëri më te mirë, një Shqipëri më të begatëshme. Ne të rinjtë nuk do të kemi për ideal kolltukun, por mbarëvejtjen e Atdheut, bashkimin e vërtetë të Kombit, një bashkim që do t'a ketë burimin në zemrat e vërteta Shqiptare».

Regjimi i Zogut, atyre që kishin një farë instruksio ni dhe nuk ishin me regjimin, përpiquej t'i demoralizonte tue mos u dhënë punë. I u desh kështu dhe Enverit të sillej kështu shumë kohë pa punë, deri sa më në fund u emërua profesor në liceun e Tiranës. Në Tiranë e lanë vetëm katër muaj dhe pastaj e transferojnë në Korçë, profesor të liceut ku atje, disa vjet më parë, ay ishte një nga nxënësit përparimtarë.

Liceu i Korçës nuk kishte më tani karakterin e mëparshëm. Grushti i regjimit Zogist ndihej më tepër. Elementi progresist ishte i ralle dhe persekutohej vazhdimisht. Profesorët francezë nuk ishin më ata të parët, por reaksionarë, monarkista, fashista, dishipuj të Charles Mauras. Por krahas me këtë ndryshim në kuadrin drejtonjës të liceut kishte ndryshuar dhe mentaliteti dhe shpirti i nxënësve të liceut. Nxënësit kishin bërë hapa përpara, pse rezistenca kundër politikës pro-fashiste të Zogut dhe organizimi fillestar i lëvizjes kishte filiuar. Puntorët e Korçës po organizoheshin dhe influenza e tyre

ndihej kudo. Në Shqipëri kishte kohë që kish ardhur nga Evropa, ku qëndronte i aratisur, komunisti Ali Këlmendi, organizator i çeliktë që vdiq më vonë tyberkuloz nga vuajtiet nëpër burgje dhe fushat e internimit të Zogut. Me Ali Këlmendin Enveri ishte parë vetëm një herë. Ishte parë në Gjinokastër në kohën e vakancave, kur ay ishte kthyer nga Franca Ishin ditët e fundit që Aliu do të jetonte në Shqipëri, pse pas një kohe të gjatë internimi në kështjellën e Gjinokastrës kishte marre urdhër ekspulsimi jashtë Shqipërisë nga organet qeveritare të Zogut. Enveri mban mënd tekstualisht porosin e fundit që i dha Ali Këlmendi, kur po ndahesh: «Me gjith shtypjen dhe terrorin e Zogut, ne duhet t'organizojmë luftën kundra regjimit».

Ali Këlmendi kishte punuar në çdo vënd ku e dërgonin t'internuar, ay shprehte me forcë direktivat e Frontit popullor anti fashist. Punën më të madhe Aliu e bëri në Korçë, pse ay gjeti punëtorë të vendosur si Koçi Xoxen, Sotir Vullkanin, Pandi Kriston, Pilo Peristerin etj. Ay luftoi dhe demaskoi arkeo-marksistin Niko Xoxin dhe influencën e tij. Puna e Ali Këlmendit kishte zënë rrënjë. Kështu që në Korçë, Enveri gjen një terren të përgatitur, puna organizative e Ali Këlmendit shihesh kudo Puntorët Korçarë kishin kaluar nga shumë etapa organizimi, grevat e tyre kundër regjimit kishin sjellë ndërhyrjen brutale të xhandarëve të Zogut,

arrestimet e ndjekjet e elementit përparimtar bëheshin me seri, por me gjith atë lidhjet në mes të puntorve ishin forcuar, ishin krijuar organizata puntorësh si shoqëria «Puna» etj, të cilat e shqetësonin Qeverin e Zogut. Nxënësit e liceut të Korçës ishin krahas me puntorët e Korçës në grevat dhe demonstratat dhe ata dëgjonin me dëshirë dhe me vretje mësimet e profesorit të ri që me tendencë i u flet për shekullin e ndritur që përgatiti revolucionin e Francës, që i u këndon «Zjarrin» e Barbusse-it dhe Romain Rolland.

Enveri bije në kontakt me shokët. Ishte koha kur duhej që komunistat të futeshin në masat e gjëra të popullit dhe të përdorin format legale për organizimin e rezistencës dhe të frontit kundra fashizmit. Në këtë drejtim komunistët e Korçës kishin arrijtur rezultate të shkëlqyeshme. Në zgjedhjet lokale, Bashkiake, ata patën një sukses të math. Shoqëria jashtë-shkollore u transformua prej komunistëve të Korçës në një organizatë masash dhe ku ata kishin të gjithë drejtimin në duart e tyre. Qeverija e Zogut u detyrua të marrë masa dhe të shpërndajë shoqërinë jashtë-shkollore. Rivista «Rilindja» organ që mbahej dhe drejtohej nga elementi përparimtar i Korçës dhe që shfrytëzonte format legale t'aktivitetit, përhapte në masë idetë përparimtare. Ajo u mbyll prej regjimit. Një tjetër rivistë del në vënd të saj, revista «Bota e Re», me ton të ndryshëm por me përmbajtje si

e para dhe që drejtohet në radhë të parë nga elementi komunist i organizuar që di të eci në çdo situatë.

Me gjithë masat e regjimit Zogist për të shtypur lëvizjen, puna vazhdon pa ndërprerje. Bëhen tentativa më të dëndura për organizimin e rezistencës dhe të frontit anti fashist në të gjithë Shqipërinë, një front kundër politikës Zogoliane që po e shpinte vendin drejt një bashkimi të plotë me Italinë, kundër rrezikut të imperia-lizmit fashit që kërcënonte vëndin t'onë me invazion. Në Korçë puntorët komunistë gjakosin agjentët e fashi-zmit dhe hedhin zërin e alarmit. Por pengesat për rea-lizimin e këtij fronti ishin të mëdha. Pengesa kryesore ishte se nuk kishte një Parti Komuniste t'organizuar që të mund të kanalizonte përpjekjet e perbashkëta të po-pullit, të bashkonte forcat e shëndosha, t'organizonte këto dhe të drejtonte rezistencën. Kishte vetëm grupe ko-muniste t'izoluara dhe të përçara, pa vijë dhe pa pro-grame të caktuara. Pikpamjet e këtyre grupeve nuk i-shin të qarta. Përpjekjet e grupit komunist të Korçës, që kishte në krye shokë me eksperiencë dhe me pikpamje më të drejta, u përqëndruan piksëpari në këtë drejtim, për arrijtjen e një bashkimi në një Parti të vetme. Në krye të këtyre përpjekjeve ishte dhe profesori i liceut të Korçës Enver Hoxha. Vendosmërija e tij dhe pik-pamjet e tij të qarta u vunë në këtë shërbim dhe fjala e tij, përpjekjet e tij ushtronin influencë të dukëshme në

komunistët e vërtetë që ishin të vendosur qind për qind për mbrojtjen e Atdheut nga rreziku që i kanosesh.

Në Jenar të 1939 Qeverija e Zogut që i kishte rënë erë të një lëvizje t'organizuar, areston dhe hedh në gjyq një numur të math komunistash. Në mes të tyre arrestuan dhe shumë veta nga grupi komunist i Korçës. Enveri u kallzua nga profesorët reaksionarë të liceut si një pjestar i kësaj organizate subversive, por qëndrimi heroik i shokëve komunistë t'arestuar që nuk treguan asnjë emër, detyroi Ministrinë e Mbrëndshme të liminonte arrestimet.

* * *

Ngjarjet e ditëve të para të Prillit 1939 e gjejnë Enverin në Korçë, gjithënjë në krye të përpjekjeve për organizimin e një fronti të përbashkët anti-fashist. Por ky ishte larg realizimit dhe Italia po hynte në Shqipëri. Në të katër anët e Shqipërisë populli është më këmbë, ay demonstron nëpër rrugët dhe kërkon armë, por Qeverija e Zagut, që i ka marrë me kohë masat për vënten e saj bën veshin e shurdhër dhe hesht. Më 4 Prill Korça jep senjolin e kryengritjes. Nën udhëzimet e qendrës së grupit komunist të Korçës, ku Enveri bën pjesë, organizohen njera pas tjetrës demonstrata të mëdha popullore, që kishin për qëllim t'armatosnin popullin dhe të formonin çetat e para që të luftuar jtalianët. Në Bashkimin e Korçës nga komunistët e Korçës provokohet

mbledhia për krijimin e një komiteti «De salut publique», në mes të delegatve puntorë ishte dhe Enver Hoxha. Por formimi i këtij Komiteti të rezistencës u sabotua nga borgjezija reaksionare e vëndit e frymëzuar nga trockisti Zai Fundo, i cili ishte kthyer në Shqipëri, si e dhe nga njerëzit e regjimit të Zogut që ishin shitur kokë e këmbë ne Italia. Prefekti i Korçës kanoset se do të qëllojë, por me gjith atë puntorët dhe elementët përparimtarë nuk ndalen: ndër vënde publike të qytetit puntorët kishin hapur listat për t'u shkruar vullnetarë. Me mijra vëte u regjistruan. Por duheshin armë dhe këto ishin në dorë t'ushtrisë së Zogut, e cila kishte marrë urdhër kategorik të shtypi çdo tentativë rebelioni për të mbrojtur tërheqjen e Mbretit burracak dhe tradhëtor dhe mbasandaj t'u dorëzohej Italjanëve. Në këto kondita që e pa-mundur të pengohej përparimi i trupave t'agresionit. Rezistenca nuk u shua as me okupacionin e Italisë, as nga terrori i tij. Tash shtrohej detyra që populli të rokte armët dhe të hidhej në një luftë të pa prerë kundër okupatorit. Puntoret e Korçës ishin gati në shënjën e parë t'alarmit. Të rinjtë e qytetit me nxënsit e liceut në krye ndisnin në masat e gjëra të popullit urrejtjen dhe shpirtin e luftes kundër zaptontjesit dhe agjentëve të tij. Grevat, protestat vazhdonin edhe për arësye më të vogla, me qëllim që të pengonin okupatorin. Asnjë herë nuk i u nënështruan disiplinës dhe rre-

gullave të tij, sabotuan sistematikisht rregjistrimin e të rinjve n'organizatat e ndryshme fashiste, sabotuan mbledhjet dhe manifestimet që kërkonin të bënin fashistat për qëllimet e tyre, hyjnë në masat e gjëra të popullit dhe të rinisë dhe bënë punë politike me ta. Të gjitha këto kishin një burim: grupin komunist të Korçës. Puna e këtij grupi ishte e organizuar dhe merrte nga dita në ditë proporcione të gjëra sidomos në Korçë, ku kishte qendrën e tij, Ishte e pamundur kështu që kjo punë të mos binte në syt e armikut. Një ditë fashistët me demagogjin e tyre të zakonëshme, shpallën një manifestim të math që do të bënte populli i Korçës për të nderuar kujtimin e dëshmorit Themistokli Gërmenjit. Për t'i dhënë më tepër rëndësi çështjes shkojnë në vëndin e festimit autoritetet më të larta dhe federalët e vëndit me sekretarin e Përgjithshëm të Partisë Fashiste Tefik Mborja. Por grupi komunist i Korçës dha kushtrimin për sabotimin e manifestimit dhe në sheshin e ceremonisë nuk shkuan përveç se kryetarët fashistë. Puna kaq e organizuar e grupit të Korçës hoqi vrejtnjen e autoriteteve. Enveri që atë ditë pushohet nga puna me këtë modifaçon: «është kundra regjimit, s'ka pranuar të shkruhet fashist dhe kanë shkuar kundra tij shumë raporte në Luogotenencë nga ana e Tefik Mborjes». Autoritetet fashiste theshnin të drejtën.

* *

Enveri s'mund të qëndronte më në Korçë. Me urdhërin e qendrës së grupit të Korçës ay transferoi qendrën e aktivitetit të tij në Tiranë. Kjo ishte e nevojshme jo vetëm për të fshehur gjurmat autoriteteve, por sidomos për zgjërimin dhe organizimin më të mirë të lëvizjes dhe në qendrat e tjera të Shqipërisë.

Në Tiranë pas shumë kohe pa punë ay gjeti sa për sy e për faqe një dyqan, dyqanin me emrin «Flora» në rrugën e Dibrës, i cili u bë shumë shpejt qendra e pjekjeve të vazhduara me shokët që drejtonin dhe organizonin lëvizjen. Tentativat ishin të sqaroheshin mirë grupet e ndryshme komuniste në Shqipëri, të hidheshin poshtë pikpamjet e gabuara, të braktisnin grindjet në mes tyre, të bashkoheshin në një Parti të vetme, konditë sine qua non për organizimin e luftës. Duhesh luftuar ashpërsisht trockisti Aristidh Qëndro dhe arkeo-marksisti Niko Xoxa, të cilët bënin çmos që grupet e ndryshme komuniste të vazhdonin luftën me njeri tjetrin, gjë që ishte në favor të fashizmit. Duheshin përpjekje, tratativa për arrijtjen e këtij bashkimi, për të cilin Enver Hoxha kishte vënë gjith përpjekjet e tij, por më kryesorja nga të gjitha ishte vetë lufta kundra okupatorit që do të realizonte bashkimin. Në këtë drejtim komunistët e grupit Korçës ishin pro aksioneve direkte dhe të gjithanëshme kundër inva-zorit: «trakte, demonstrata, sabotazhe, atentate, etj.» Në kon-

formitet me këtë vijë hidhet në Tiranë trakti i parë që në muajt e parë të vitit 1941, ku thirrej populli të ngrihesh në luftë. Traktin e shkroi vetë Enveri, e shtypi vetë dhe ay vetë mori pjesë në shpërndarjen e tij. Kjo fletë mbante si firmë P. K. SH. (Partjia Komuniste Shqiptare). Ky trakt u ndoq prej një trakti tjetër i shkrojtur prej Enverit dhe i shtypur në shtyp-shkronjë fshehurazi prej komunistit Mihal Duri. Ky trakt mbante firmën P. K. SH., Trakte të këtij lloji u hodhën dhe nga grupe të tjera komuniste po me firma P. K. SH., por përmbatja dhe qëllimi ishte një soj me të parat. Çdo grup përpiquej të dilte si Parti Komuniste. Bashkimi nuk ishte arrijtur, por rezistenca vazhdonte. Gjer atëherë ishin bërë mjaft demonstrata antifashiste, greva dhe sabotazhe, sidomos nëpër qendra puntorësh dhe nëper shkolla. Shumë puntorë kishin dezertuar nga kantierët dhe fabrikat ku punonin për hesap të okupatorit, shumë të tjerë ishin hedhur në gjyq si sabotatorë. Të rinjtë që thirreshin nën armë nuk paraqiteshin dhe okupatori detyrohesh të mirrte masa duke internuar familjet e tyre. Me udhëzimet që dilnin nga një burim i vetëm arsimtarë dhe nxënës ishin bashkuar kundra okupatorit dhe tendencave t' agjentave të tij si Ernest Koliqi me shokë për italianizimin e shkollave shqipe. Greva t'organizuara u bënë në shkollat e Vlorës e te Shkodrës për të kundërshtuar disiplinën dhe rregullat fashiste ne shkollë. Shumë nxënës u arrestuan. Një si-

tuatë akoma m'e vështirë për armikun u krijua sidomos gjatë luftës italo-greke, ku i tërë populli u ngre kundra me rezistencë pasive ose me sabotazhe dhe shumë herë duke rëmbyer dhe armët për t'u bashkuar me ushtrinë greke. Komunistat Vasil Shanto, Qemal Stafa dhe Xhevdet Doda natën e dytë pas deklarimit të luftës së Italisë kundra Greqis kanë shkrojtur në muret e qytetit të Tiranës: Poshtë Fashizmi, Poshtë lufta Italo-Grege, të rrokim armët. Okupatori u shterngua të shpëmgulë popullata të tëra nga Shqipëria e Jugës, të bëjë arestime në masë, të mendojë serizisht jo vetëm për frontin por edhe për prapavijën. Burgosen, internohen gjatë kësaj kohe mbi 6000 vetë. Ushtarët shqiptarë t'inkuadruar me forcë nga italianët dezertojnë nga fronti grek, ata përqëndrohen në kampet e Shijakut. Enver Hoxha shkruan traktin ku i bën apel ushtarve shqiptar t'internuar në Shijak të hidhen në male. Ttakti mban firmën P. K. S, ay shpërndahet nëpërmjet rreziqeve të mëdha nga komunistët më të vendosur siç ishin Mihal Duri dhe Misto Mame. Shumë prej këtyre ushtarve u hodhën në mal, patriotë të tjerë muar po këtë rrugë ose bënë jetë ilegala nëpër qytete. Lufta e armatosur kishte filluar. Andej nga Marsi 1941 Komiteti drejtonjës i grupit komunist të Korçës merte vendim të dërgoheshin komunistët e parë në male për t'organizuar çetat. Po n'atë kohë në rrethet e Pezës Myslim Peza me një tok katundarë binte

në përpjekje me fuqirat kuislinge të Shefqet Vërlacit. Pas kësaj përpjekje Enveri shkon vetë të takojë Myslim Pezën. E takon natën në pyll, atje afër Damjanit, ku më vonë do të bjerë duke lëftuar heroikisht shoku i tij i vjetër Mihal Duri. Enveri i spjegon Myslim Pezës qëllimet e luftës, ashpërsin e luftës dhe nevojën e organizimit të rezistencës. Myslim Peza e pranoi: «Jam me juve tha, se ju komunistat jini të popullit dhe s'u dhimbet jeta për popullin». Myslim Peza qëndroi gjer në fund me Enverin dhe me luftën. Që atëherë u thirrën nga Korça komunistët: Gjin Marku, Themeli, etj. Qëllimi ishte lë forcohej sa më parë çeta e Myslim Pezës, të krijoheshin çeta të tjera, t'organizoheshin njisitë në qytete, të goditej okupatori në katër anët, të skjarohet populli me anë traktesh dhe agjitacioni, të grumbulloheshin sa më shumë armë për të furnizuar çetat. Grupet e tjera komuniste vepronin po një soj. Qemal Stafa i ndjekur nga policija nëpër mes rreziqesh shkon dhe takon me Myslim Pezën, Vasil Shanto i veshur si hoxhë për të gënjyar spiunët e fashizmit që e ndiqnin këmba këmbës përgatitëte sabotazhe, Kristo Themelko (Shule) i ndjekur nga policija, organizonte puntorët për rezistencë.

Pas shumë përpjekjesh dhe aksionesh të ndryshme si prerje vijash telefonike, hedhje deposh municioni n'erë etj, që vazhduan gjatë Prënverës 1941 arrihet me një

mijë mundime krijimin e një komisioni të përbashkët të grupeve komuniste për të drejtuar aksionet. Të gjithë ishin për aksione me përjashtim të krerëve të grupit të së rinjve Anastas Lula e Sadik Premte. Ky komisjon për të filluar punën e tij mori vendim për bërjen e demonstratës së 28 Tetorit në Tiranë, që përfaqësonte për fashizmin «triumfin» e tyre dhe aniversonin e luftës kundra Greqisë. Në ballë të demonstratës doli vetë shoku Enver. Nën udhëheqjen e tij demostra u kthye në ndeshje me karabinjerët fashistë që ishin vërsulur të shpërndanin me armë turmën e madhe të demonstronjësve. Por demonstratorët e vijës parë, komunistë të vendosur, me gurë dhe shkopinj në duar, duke marrë shëmbull nga udhëheqësi i tyre, u gjakosën me karabinjerinë, shpar talluan forcat e tyre dhe demonstrata vazhdoi gjer në fund me suksesin më të math. Që atë ditë jeta legale për Enverin u bë e pa-mundur. Me vendim të Komitetit të grupit të Korçës, Enveri hidhet në ilegalitet.

* * *

Suksesi i demonstratës së 28 Tetorit ishte një fitorje e madhe e vijës politike që ndiqte, predikonte grupi komunist i Korçës. Ay solli entuziazmë në popull dhe forcoi besimin në shumë antarë të grupeve të tjera komuniste se me të vërtetë udha e aksioneve direkte ishte udha e bashkimit të grupeve dhe e fitorjes mbi fashizmin. Konditat për bashkimin e grupeve të ndryshme po

arriheshin. Nga ana tjetër ngjarjet ndërkombëtare e shpejtonin këtë gjë. Popujt fqinjë të Jugosllavisë kishin rënë dhe ata nën zgjedhën e rëndë fashiste dhe atje lufta e armatosur partizane kishte filluar. Gjermania hitleriane duke shkelur tradhtisht traktatin e miqësisë e të mos sulmimit me Bashkimin Sovjetik, kishte sulmuar Atdheun e Sovjetëve. Një forcë tjetër e madhe, kampjoni i paqës, i lirisë dhe i demokracisë së popujve, kish hyrë kështu në luftë kundër forcave t'errëta fashiste. Si për të gjitha vëndet e okupuara dhe për Shqipërinë e vogël, hyrja e Bashkimit Sovjetik në luftë sillte shpresa të mëdha për fitorjen dhe nga ana tjetër demaskonte teorit e gabuara të disa komunistave Shqiptarë dhe sidomos të tradhtarve Anastas Lulo dhe Sadik Premtes. Koha s'priste më. Duhesh nxitur në përpjekje për bashkimin e grupeve, për krijimin e një Partije të vetme me elemente më të sprovuar, më besnik që të ishte në gjëndje t'organizonte dhe të drejtonte rezistencën në popull, t'a çonte përpara dhe t'a lidhte me lëvizjet anti-fashiste të popujve të tjerë. Më 8 Nëntor 1941 nën terrorin më të math t'armikut që gjurmonte pa reshtur dhe lëvizjet më të vogla të patriotëve, mbledhet në Tiranë Konferenca e I-rë e grupeve. Enveri ishte delegat i grupit të Korçës. Në mes të shokve të tjerë ndodheshin Qemal Stafa, Koçi Xoxe, Kristo Themelko, Tuk Jakova, Vasil Shanto etj. Pas diskutimesh për të sqaruar pikpamjet

e gabuara, u formua Partija Komuniste Shqiptare dhe nga mbledhja doli Komiteti Çentral Provizor i Partisë. Të gjitha grupet u shkrinë. Trakti i parë i Komitetit Çentral Provizor që lëshoi kushtrimin e luftës pa kompromis dhe pa rezerva kundra okupatorit dhe shërbëtorve të tij u redaktua prej Qemal Stafës dhe Enver Hoxhës. Partija u bëri thirrje të vazhduara masave të bashkonin forcat e tyre në një front të vetëm për çlirimin e Atdheut. Duhej organizuar Partija në Tiranë, nër qendrat e tjera të Shqipërisë dhe nëpër fshatra. Punë e vështirë nën terrorin e math fashist. Gjith shokët e Komitetit Çentral Provizor me heroizme kanë shkuar në të gjitha qendrat e Shqipërisë dhe kanë organizuar Partinë me frymën e re dhe simbas vendimeve të Komitetit Çentral Provizor. Enveri qëndroi në Tiranë për organizimin e drejtimin e punës në kryeqytet. Ay shkonte celulë më celulë për të çuar drejtimin e Partisë, për të konsoliduar organizimin, për të luftuar pikpamjet anti-marksiste të disa elementëve dhe sidomos t'Anastas Lulos dhe Sadik Premtes të cilët lëftonin kundra vendimeve dhe vijës së Komitetit Çentral Provizor. Ata sabotonin organizimin, sabotonin mbledhjet e Partisë dhe të Rinisë, sabotonin aksionet që vendoseshin prej Komitetit Central. Ky ishte rreziku më i math për Partinë Komuniste Shqiptare e porsa formuar prej grupeve të ndryshme. Këtu duhej përgjuar, organizuar fort dhe luftuar të tilla pikpamje

anti-parti. Envëri i kishte parasysh të gjitha këto në punën e tij që zhvillonte në Tiranë ku Anastas Luloja kishte qendrën e veprimtaris së tij. Nga ana tjetër Partija Komuniste Shqiptare i vuri për barë vehtes të popullarizonte Bashkimin Sovjetik, sigurimin e vetëm në fitorje, të popullarizonte ushtrinë e lavdishme të kuqe dhe të bënte të njohur në popull ç'ishte Bashkimi Sovjetik për botën dhe për Shqipërinë. Armiqtë do t'a përdorin këtë vepër të madhnishme të Partisë për t'akuzuar Partinë t'onë të shitur tek Sovjetët. Kjo ishte taktika e fashistave dhe shërbëtorëve të tij. Traktet e Komitetit Central të Partisë, të cilat gadi të gjitha janë shkrojtur prej shokut Enver kanë për qëllim të nxitnin popullin për lufte, t'organizojnë luftën e armatosur, t'organizojnë Frontin N. Çl. etj. Duhet bashkuar populli në një platformë të vetme politike dhe organizative për t'a luftuar fashizmin sistematikisht dhe me sukses Enveri në Tiranë si edhe gjithë shokët e tjerë në qarqe bëjnë konferenca të panumërta me patriotë të ndryshëm për t'u shpjeguar këtyre qëllimet e Partisë dhe detyrat që i visheshin çdo patrioti përpara n'ato momente. Partija u ngrre me të gjitha forcat e saj kundër dallaveres dhe oportunitizmit të «patriotëve të traditës» që e kishin trajtuar Shqipërinë gjithnjë si plaçkë tregu për interesat e tyre dhe për shtypësit imperialistë. Partija u ngrre kundër shtypjes shekullore të mbrëndëshme, paragjykimeve

dhe antagonizmit fetar, që s'e kishin lënë kurrë popullin shqiptar të bënte një hap përpara. Partija shkoi në fshat për të ngjallur patriotizmin në katundarët e Shqipërisë dhe për t'i hedhur këta në luftë. Pas formimit të Partisë dhe me përpjekjet e saja të pa-lodhura lufta e popullit për çlirimin hyri në fazën e organizimit. Me shtyp, me propagandë klandestine, t'organizuar, Partija demaskoi manevrat e politikës s'armikut, propagandën e tij, demagonjine dhe qëllimet e tij, mobilizoi për luftë masat e gjëra të popullit, në radhë të parë puntorët, katundarët dhe të rinjtë, i edukoi politikisht, i bëri koshjentë të situatës dhe të drejtave të tyre që nuk mund të fitohejshin veç se me luftë dhe me sakrifica. Vija e Partisë u bë në pak kohë vija e gjith popullit t'onë puntorë dhe liridashës. Formimi i Partisë ishte sigurija m'e madhe në fitorjen e luftës dhe t'independencës. Partija organizoi që në ditët e para të formimit te saj njisitet guerile të qyteve. Nën drejtimin direkt t'Enverit antarët më të mirë të Partisë si Vojo Kushi, Misto Mame, Gogo Nushi, Beqir Balluku, Xhorxhi Martini, Shyqri Ishmi, et. kryen në Tiranë aksionet më të guximshme dhe më të lavdishme të luttës s'onë të fillimit. Sulmoheshin depot në Tiranë, hidheshin n'erë, digjeshin centrale telefonik, sulmoheshin qendra ushtarake, sulmoheshin dhe shkatroheshin reflektorët e aviacionit. Mihal Duri me njisitet e tij sulmonte shtyp-shkronjat, shkatëronte rjetat telefonike t'armikut,

sulmonte agjentët e Ovres dhe të Simit. Spiunë të fashizmit vriteshin gati çdo ditë. Tirana ishte bërë tmer për fashistët, morali i popullit po ngrihej. Organi i Partisë Komuniste «Zëri i Popullit» që e drejtonte vetë Enveri dhe ku shkruante pjesën më të madhe të artikujve sqaronte dhe udhëzonte popullin për kryengritje. Në Vlorë, nën udhëheqjen e Hysni Kapos sulmohen gazerat e milicisë dhe të karabinjeris, hidhen n'erë depot e marinës të qafes së Koçiu, në Korçë nën udhëheqjen e Pandi Kristos vriten agjentët e armikut, digjet shtëpia e fashjos, sulmohet fabrika e birrës Korçës etj. Në shkodër gueriljet sulmojnë burgjet dhe vrasin spiunët. Aksionet dhe ekzekutimet bëheshin me vendosmërinë më të madhe. Vendimet e Komitetit Central Provizor të Partisë ekzekutoheshin me precizionin më të math nga shokët Komunistë, të cilët duke qenë vetë në ballë të çdo aksioni, të çdo demonstrate, jepnin shembullin e disiplinës, të heroizmit që tregohej nga Partija. Ata bënë që Partija e jonë të fitoië admirimin e masave të gjëra të popullit dhe besimin më të math. Kajo Karafili vret në mes të qytetit dhe në sy të karabinjerve dhe të policive spiunin e famëshmë Beqir Kazazin. Qemal Stafa, Perlat Rexhepi, Misto Mame, Mihal Duri, e qindra shokë të tjerë me vetmohimin e tyre çajtën rrugën e akteve heroike mbi të cilën do të ecin së shpejti me mijra e me mijra të tjerë. E tillë ishte në fakt shkolla e

Partisë, që u mësonte antarve të saj idenë e sakrificës për kauzën e çlirimit të popullit. Kur shokët më të mirë të Partisë binin heroikisht në fushën e nderit për Partinë dhe për popullin, Anastas Lula, Sadik Premte dhe disa shokë të tjerë vazhdonin veprën e tyre kundra Partisë. Komiteti Central Provizor i Partisë mori vendimin të marrë masa. Shoku Enver u ngarkua të mbledhi faktet kundra veprimtarisë së tyre anti-parti, të thre-si një konferencë të Partisë dhe të formulojë akuzën kundra këtyre elementave deviatorë. Konferenca u bë në Tiranë, në një kohë kur terrori i armikut ishte i math. Për dy ditë rjesht Enveri e Shokët e tjerë sulmuan me fakte në dorë Anastas Lulon dhe Sadik Premten dhe pasi këta u përpoqën deri në fund të mpronin pikpamjet e tyre kundra Partisë u muar vendimi unanim për dbimin jasht nga Partija të troskistave Anastas Lula dhe Sadik Premte. U muar masa të tjera kundra atyre që pasonin Anastas Lulon.

Nën kushtrimin e Partisë, demonstratat anti-fashiste të popullit u bënë më të dendura në çdo qytet dhe shumë herë u kthyen në përleshje t'armatosura me forcat e okupatorit, radhët e patriotëve t'aratisur dhe ilegal u mbushën me mijra të tjerë. Çetat e maleve filluan goditjet e para.

Në kufitë Veriore të shqipërisë popujt e Jugosllavisë kishin kohë që kishin filluar luftën kundër okupa-

torit. Malet ishin plot me partizanë. Lufta e popujve fuqinjë ishte ndihmë e madhe për luftën t'onë, ajo na inkurajonte, na ngrohte zemrat, na forconte, sido që nuk dihej gjë konkrete se sa partizanë jugosllavë ishin në male dhe se ku luftonin. Por lufta na bashkonte, me gjithse lidhjet mungonin. Shumë patriotë Jugosllavë që kapeshin n'aksione t'armatosura kundra forcave fashiste silleshin në burgjet dhe në kampet e përqëndrimit të Shqipërisë, ku vriteshin dhe torturoheshin pa mëshirë. Aty nga viti 1941 njsitet t'ona sulmuan një nga këto kampe qëndrimi dhe nga t'internuarit u çliruan prej njsiteve t'ona shumë patriotë të shquar Jugosllavë si Miladin Popoviç-i. Të tjerë jugosllavë japin jetën për vëllazërimin e popujve t'onë, për të forcuar lidhjet dhe kontaktet me partizanët jugosllavë e shqiptarë që male e male i ndanin nga njëri tjetri. Profesori Filip Popoviç dhe heroi Vaso Strugari luftojnë dhe vriten heroikisht në Liqenin e Shkodrës duke dashur të mbrojnë deri në vdekje radio-stacionin që iu kishte dorëzuar Enveri për të bërë lidhjet me forcat e Peko Dapceviçit dhe Milutinoviçit. Qindra episode të tjera si këto që vazhduan njëra pas tjetrës rritnë besimin e shokëve t'anë të luftës në luftën e shokve Jugosllavë dhe forcuan dhe vulosnë për herë dhe më shumë miqësinë dhe vëllazërimin e popujve shqiptarë dhe jugosllavë.

* *
*

Okupatori që kuptoi rolin e math të Partisë që në veprimet e para të sajë nxitoi për të marë masa për t'i bërë ballë situatës që po krijohej. Zëvendësoi më një herë qeverinë e Verlacid me qeverinë «e grushtit të fortë» të Mustafa Krujës, organizoi një propagandë më të madhe demagogjike, rifilloi persekutimet në shkallë më të gjërë dhe ngriti në sistem terrorin mbi popull.

Por Partija nuk u tut. Enveri vazhdonte të qëndronte në Tiranë për të drejtuar punën dhe aksionet. Shtëpit e popullit fukara të lagjës së Tiranës Vorri i Bamit u bënë qendrat kryesore, nga ku dilnin parullat dhe direktivat e Partisë që mobilizonin masat për luftë dhe i shtinin datën armikut. Enveri është në kontakt të përditshëm me shokët që kanë përgjegjësi të ndryshme. Ai i udhëzon këta dhe gjith shokët e qarqeve në luftën e tyre dhe nëpër mjet tyre mer eksperiecën e masave. Shoku i tij më i afërtë Koçi Xoxe arestohet, Qemal Stafa pasi mer udhëzimet nga Enveri për të shkuar në Vlorë, rrethohet dhe vritet në lagjen e Tiranës, të tjerë shokë bien dëshmorë. Terreni ishte përgatitur dhe koha kishte ardhur kur Partija, bashkë me aksionet dhe me luftën, duhej të shtonte përpjekjet dhe të realizonte bashkimin e të gjith popullit në një front të vetëm. Duhej një punë e pa reshtur në këtë drejtim, duhej bërë pjekje me shumë njërëz, pjekje shumë herë të rezikëshme pse shumë nga ata pseudo-nacionalista s'e kishin hedhur

maskën dhe nën rogos mbanin lidhje me okupatorin. Enverit i a don puna shumë herë të piqet me njerëz të tillë që më vonë do t'udhëheqin Ballin në veprën e tradhëtisë. Enverit i a do puna të shkojë nga një vend në tjetrin, për të ndjekur vetë punën politike në masa dhe lëvizjet e tija janë bërë tëvështira pse okupatori e kërkon në çdo anë si njeriun më aktiv të rezistencës. Me letërnjoftime fallso, i maskuar, me jetë në rrezik ay shkon nga njëri vënd në tjetrin, bisedon me puntorët dhe me fshatarët, me patriotë të çdo shtrese, ay kapërxen shumë herë tok me Qemal Stafën postë blloqet e Tiranës, që ruheshin prej spiunëve më të regjur Enveri me koncepte të qarta politike, që i a ka mësuar Partia, demaskon manevrat e okupatorit dhe t'agjentëve të tij, ushtron influencë të madhe me patriotët që janë hutuar nga ngjarjet e 7 Prillit dhe kanë mbetur idiferentë, ose dhe me të tjerë që janë gënjyer nga demagogjia e okupatorit dhe kuislingëve. Ay pregatit rrugën e bashkimit dhe të Frontit. Për bri kësaj pune Enveri s'haronte luftën e gueriljeve dhe të njisiteve. Por nga të tilla lëvizje shumë herë ka shpëtuar në qime nga vdekja e sigurtë. Në shtëpinë e puntorit Shyqri Këllezit në Tiranë ishte një nga depot e shumta t'armëve, të librave dhe të trakteve të Partisë. Enveri ndodhet atje me Qemal Stafën, Kristo Themelkon, etj. për të hartuar traktet e Komitetit Central. Një korier i rezistencës hyn brenda me një

frymë dhe u bërtet shokve të ikin se policija po i rrethon. Me të vërtetë, ndërsa kompanira policësh dhe karabinjerësh po përgatiten të rrethojnë shtëpinë dhe të shqyejnë hyrjen kryesore, Enveri me shokët arrijtën të largohen nga ana tjetër. Këto gjëra janë të zakonëshme për jetën e tijë prej militanti.

* * *

Pas dhjet muaj përpjekje dhe aktiviteti të gjithanëshëm të Partisë ishin krijuar konditat e themelimit të Frontit. Italia dhe Gjermania fashiste ishin n'apogjenën e fitoreve të tyre, por besimi në fitorjen e frontit antifashist rritej gjithnjë më shumë. Me trakte, me organin e rregulltë «Zëri i Popullit» që shpërndahej në gjithë Shqipërinë, Partija kishte arrirë të ngjallë në popull dashurin më të madhe për Bashkimin Sovjetik, për Stalinin, për Ushtrin e Kuqe Heroike. Kundër manevrave dhe demagogjisë fashiste që përpiqej të mbillte urejtjen në mes të popujve, Partija kish ngjallur në popullin t'onë dashurinë kundrejt popujve të tjerë të shtypur, sidomos kundrejt popujve të Jugosllavisë. Në Shqipëri rezistenca kishte marë proporcione të mëdha në zonat e çliruara si Peza, Opari, Tomorica, Mesapliku, Malla-kastra, etj., çetat e armatosura vepronin në luftë të hapët me okupatorin. Postat e karabinjerisë ishin spastruar, armiku ishte strukur në qytete, autokollonat e tij qarkullojnë në shoqëruara me autobllinda. Çetat vrisnin dhe zinin

rob me qindra ushtarë italianë, shkatëronin ura, rrugë, prisnin vijat telefonike, sulmonin depot e ushqimit dhe u a ndanin këto popullit. Njisitet në qytete ishin zmadhuar pa masë. Në këto kondita dhe me këtë aktiv lufte Komiteti Central i Partisë mori vendimin për organizimin e Frontit Nacional Çlirimtar. Në konferencën e Pezës që u mbledh për këtë qëllim më 16 Shtator 1942 u thirrë dhe kishin ardhur të përfaqësonin nga të gjitha shtresat e popullit dhe patriotë si Myslim Peza, Baba Faja, Haxhi Lleshi, etj. Komiteti Central i Partisë kishte deleguar Enver Hoxhën, Nako Spirun dhe shokë të tjerë. Në punimet dhe në drejtimin e konferencës u shqua për rolin kryesor Enver Hoxha. Enveri shtroi në konferencë eksperiencën që kishte mbledhur deri atëhere nga përpjekjet e masave popullore, të cilat kishin fituar besimin në triumfin e kauzës së tyre. Enveri dha kuptimin e drejtë të bashkimit që duhej, bashkim i cili do të realizohej vetën në zjarrin e luftës anti-fashiste dhe do të krijonte atë bllok të vetëm të të gjitha forcave popullore, pa dallim feje, krahine ose ideje dhe që kishte predikuar me kohë Partia Komuniste Shqiptare. Pa një bashkim të tillë ishte e pamundur t'arrihesh në çlirimin e Atdheut. Enveri shtroi gjith'ashtu nevojën e ngritjes së Këshillave Nacional-Çlirimtare, nevojën e ngritjes në luftë e sipër të një ushtrie të re popullore. Ay theksoi nevojën e goditjes dhe të shkatërrimit total t'apararit të

vjetër të shtetit që kishte kapitulluar më 7 Prill 1939 dhe të ngritjes së një pushteti të ri popullor në vënd të tij. Shoku i tij Nako Spiru, ngrii çështjen e organizimit të shëndoshë t'organizatës së Rinis që do të përmblihdhte në gjirin e saj dhe të edukonte me frymën e luftës rini-në Shqiptare. Mbi këto vija të përgjithëshme doli rezollucioni i Konferencës së Pezës, të cilat u hartuan prej Enver Hoxhës dhe Nako Spiru dhe që përbëjnë gurin e parë të themelisë së historisë së Shqipërisë së Re. Reth mbledhjes së Pezës armikut i kish rënë erë por nuk dinte ekzakt vëndin dhe qëllimet e mbledhjes. Me gjith atë ay grumbulloi forcat dhe i lëshoi në sulm për të rrethuar dhe për të djegur gjith zonën. Po ishte von, Konferenca kishte mbaruar punën 2 ditë më parë dhe delegatët ishin shpërndarë në drejtime të ndryshme. Vetëm Enveri me disa shokë duke u kthyer për në Tiranë takon forcat armike që shkonin të rrethonin Pezën. Ata kishin me vehte thasët me material të Konferencës të botuara në shtyp-shkronjën ilegale që kishin të fshehur në mal. Qenë në rrezik të kapeshin, po shpejtësija dhe manovrimi i tyre depistoi vërejtjen e armikut, ata fshehën materialin në një han mb'anë të rrugës dhe me një farë taktike i shpëtuan nga duart e armikut, i cili u kujtua von dhe kontrollojë të nesërmen n'anën ku gjeti dhe zuri materialin, i cili u ribotua përsëri dhe u shpërnda në gjith Shqipërin. Nako Spiruja që kish marë drej-

tim tjetër për të shkuar në Durrës u kap nga forcat e operacionit Italian, u burgos, por ai më vonë arratiset nga burgu.

Në Pezë përveç të tjerave, si sinjal i parë i bashkimit dhe vendimit për kryengritjen, delegatët kishin mbetur dakord të bëheshin aksione me karakter të përgjithshëm në të gjithë Shqipërinë. Aksioni u krye me sukses, u prenë gjithë rjetat telefonikë të Shqipërisë dhe u sulmuan auto-kollonat e armikut. Vetëm një nga delegatët e konferencës nuk e zbatoi detyrimin që kishte marrë përsipër, ky ishte Abaz Kupi i cili vazhdoi në këtë rrugë gjersa u hodh jashtë nga Këshilli i Përgjithshëm. Partija që ishte themeltarja dhe shtylla e çelniqtë e Frontit N. Çl. mobilizoi gjithë forcat e saja për realizimin e kësaj veprë të madhe. Pa marrë parasysh reziqet, nën ndjekjet më të egra të Mustafa Krujës, komunistët dhe patriotët mblidhnin popullin e fshatrave dhe qyteteve dhe organizonin këshillat N. Çl. Një valë e madhe entuziazmi e përshkoi popullin, një valë e madhe aksionesh dhe sulmesh të vazhuara plasën në të gjitha anët e Shqipërisë pas Konferencës historike të Pezës. Përpara rezistencës së luftës heroike të popullit, qeveritë kuislinge që erdhën njëra pas tjetrës, falimentuan në planet dhe në metodat e tyre dhe okupatori humbi çdo shtetësi që t'i bënte ballë kryengritjes. Si reaksion kundër vendimeve të Pezës okupatori nxiti dhe krijoi forma të

Kombëtar dhe të tjera organizata duke filluar gjithashtu dhe operacione në shkallë të gjërë në të gjithë prefekuratat e Shqipërisë. Balli në të cilin merrnin pjesë të gjithë bejlerët dhe borgjezija reaksionare, grupi i Zjarrit, i vet-quajtur komunist, por në realitet me tendencë të theksuara arkeo-marksiste, organizoi luftën tok me okupatorin kundër Frontit N. Çl. dhe luftës së popullit Shqiptar. Me demagogji krerët tradhtarë të Ballit Kombëtar kërkonin të çarmatosnin popullin, të shpartallonin bashkimin, të shkatëronin Partinë Komuniste ose t'a izolonin këtë nga masat e popullit. Veprimtaria e tyre ishte e lidhur ngushtë me veprimtarinë e okupatorit. Në qytete dhe sidomos në Tiranë, ku aksionet ishin bërë të rezikëshme për okupatorin, ai vuri në urdhër te ditës terrorin më të zi. Çdo natë bllokoheshin mëhallë të tëra, arestoheshin, burgoseshin dhe vriteshin patriotë pa gjyq, masakroheshin njerës të dyshimtë. Për shumë kohë pas Konferencës së Pezës, me gjithë terrorin e math armik, me gjithë bllokimet dhe kontrollimet e pa reshtura Enveri vazhdon të qëndrojë në Tiranë në krye të punës, që i kishte ngarkuar Partija e tij. Okupatori e kishte dënuar me vdekje në mungesë dhe ndjekjet kundër tij ishin bërë më të dëndura. Fotografija e tij-vetëm një që kishte mund të shtjerë në dorë okupatori-ishte shpërndarë në të katër anët, por agjentët dhe informatorët

fashistë, muk mund t'u shkonte kurrë në mëndje se muratori me emër usta Hasani, me një kapellë të vjetër, me robe të shqyera dhe me fytyrë tërë këlqere, ose elektrikisti Thanas me petkë të thjeshtë punëtori dhe me veglat e zanatit nën sjetull, që u kalonte kushedi sa herë përpara, ishte vetë Enveri, njeriu që kërkohet dhe duhej kapur i gjallë ose i vdekur. Armiku kishte informata se një njeri me karakteristikat e tij që kërkohet, i pashëm, me sy të zez dhe vetulla të gjëra ishte kapur pa dokumenta dhe s'tregonte emërin, po Enveri ishte në Tiranë, në rrugën e Gazhinës, karshi postës së karabinjerisë, që ruante lëvizjet e njerëzve të dyshimtë, ishte aty dy net dhe dy ditë me radhë delegati i Komitetit Central të Partisë në mbledhjen e aktivitetit të Tiranës i ruajtur nga shokët e tij me bomba, automatikë dhe mitrolaza në duar, gati kundër çdo reziiku. Një lajmë tjetër i vjen okupatorit se policija e Prizrenit ka rënë në gjurmë të një njeriu të dyshimtë që i përngjet shumë fotografisë së Enverit. Por është taman atëhere kur Enveri ka shkuar t'organizojë Konferencën e I-rë të vëndit të Partisë që u mblodh në Labinot t'Elbasanit në vitin 1943. Në këtë konferencë të madhe dhe të parë të Partisë Enveri paraqiti raportin e gjith punës së Partisë, që nga puna fillestare e grupeve, organizimi i Partisë, forcimi i saj, forcimi i luftës, etj. Ay vuri në dukje luftën që kishte bërë Partija e jonë e re kundra elementave

deviatorë të mëngjër, kundra oportunistëve, ay vuri në dukje reziqet që e kërcënojnë Partinë nga këta njerëz, vuri në dukje gabimet dhe të metat e punës, vuri në dukje mbeturinat e sëmundjeve të grupeve, të cilat duhej luftuar me ashpërsinë më të madhe, vuri në dukje format organizative të reja mbi të cilat duhet të ecënte dhe të forcohej Partija e jonë, ay vuri përpara Konferencës së Partisë detyrën e organizimit sa më të fortë të luftës kundra okupatorit, për orgonizimin dhe forcimin e Frontit N. Çl., ay raportoi gjith aktivitetin e Komitetit Central Provizor të Partisë dhe kërkoi zgjedhjen e Komitetit Central definitiv të Partisë. Nga Konferenca historike e Partisë doli Komiteteti Central i Partisë dhe Enveri u zgjodh Sekretar i Përgjithshëm i saj. Partija Komuniste po behej një forcë e madhe, ajo ecënte me hapa të sigurta drejt rrugës që e mësonin mësuesit e mëdhenj Marksi - Engelsi - Lenini - Stalini. Fitorja e popullit t'onë ishte tash e siguruar pse Partija Komuniste, duke kaluar nga një luftë e ashpër ishte çelnikosur dhe uniteti i saj ishte i pathyeshëm.

Pas Konferencës së Partisë dhe me rekomandimin e Konferencës së Partisë Enveri thirri disa krerë të grupit të Zjarrit dhe duke i u vënë në dukje atyre punën anti-marksiste dhe tradhetare që po bënin i urdhëroi të likuidonin grupin e tyre, t'i dorëzonin Partisë kuadrot e grupit dhe gjithë punën e tyre, të hidheshin pa re-

zerva në luftë kundra okupatorit, antarët më të mirë të grupit të shkriheshin në radhët e Partisë dhe të lëftohej dhe të demaskohej, udhëheqësi i këtij grupi, arkeo-marxisti dhe spiuni i Mustafa Krujës, Zisi Andrea me pseudonim zjarri. Kjo ishte fjala e fundit e Partisë kundra grupit të zjarrit. Këtu s'kishte lëshime, o me Partinë ose në luftë me te. Grupi i zjarrit vazhdoi dhe për një kohë veprimtarin e tij nën drejtimin e Zisi Andreas. Atëhere Enver Hoxha shkroi artikullin në Zërin e Popullit, ku demaskoi napët si agjentë të okupatorit Zisi Andrenë dhe veprimtarinë e grupit të Zjarrit. Një demaskim i tillë bëri që elementat e gënjyer të këtij grupi, t'u çelensytë dhe të kërkojnë hesap nga udhëheqësit e grupit, të kërkojnë likuidimin e grupit dhe inkuadrimin e tyre në radhët e Partisë. Grupi i Zjarrit mori fund. Zisi Andrea mbaroi agjent i Ovres dhe i gestapos. Enver Hoxha u dha urdhër shokve të Korçës të pushkatonin Niko Xoxin, troxkist dhe agjent i fashizmit. Ay u ekzekutua. Anastas Luloja dhe Sadik Premtja vazhdonin luftën kundra popullit dhe Partisë. Enver Hoxha nga Labinoti dha urdhër t'arestoheshin dhe të gjykoeshin Anastas Lulo dhe Sadik Premtja. Anastas Lulo u gjykua dhe u pushkatua si tradhtar i popullit dhe i Partisë dhe sabotator. Enveri u kthye në Tiranë për t'i shtruar organizatës së Partisë vendimet e mëdha të Konferencës së Partisë. Në kalim nga Elbasani ay bëri një varg konferencash në popul

me gjith ndjekjet e policisë. Në Tiranë i erdhi lajmi se Sadik Premte kishte organizuar luftën me armë kundër Partisë, ay ishte në mal dhe njerëzit e tij kishin bërë kryengritje në çetën plakë të Vlorës, që vepronte në Mallakastër. Enver Hoxha shkoi vetë për të shtypur tradhtarët e Partisë. Ay kaloi 10 post-bloke, ku në çdo nga këto e priste vdekja. Ay kapërceu Vjosën dhe shkoi në Mallakastër, ku tok me Mehmet Shehun urdhëroi arestimin e të gjith njerëzve të Sadik Premtes. Ay mori vetë në pyetje tradhtarin dhe dorën e djathtë të Sadik Premtes Vangjon, i cili u gjykua më vonë dhe u pushkatua. Sadik Premtja kishte arritur të ndante në dysh gjith krahinën e Mesaplikut, fshatarët ishin ndaTë më dysh, me Partinë dhe me Sadik Premten. Punët e Partisë ishin bërë punët e gjith popullit t'atjeshëm. Sadik Premtja kishte zbuluar dhe format organizative dhe veprimet e Partisë. Populli i Mesaplikut priste vendimin e Partisë. Enver Hoxha i shoqëruar prej Hysni Kapos rikapërcen Vjosën dhe hidhet në malet e Tragjazit. Me mijra katundarë gra dhe burra ishin mbledhur të dëgjonin ç'do t'u thoshte Partija, ç'do t'u thoshte Enveri. Enveri për tre orë rjeshtë u shpjegoi çështjen, rrugën e Partisë, rrugën e shpëtimit, rrugën e fitores dhe u shpjegoi se Sadik Premtja me shokët e tij ishte kundër kësaj rruge, kundër popullit, kundra Partisë. Ay ishte tradhtar. Nga turma një katundar plak u ngrit dhe bërtiti:

«poshtë im bir! pse ay tradhtoi Partinë». Ky ishte babaj i një të riu që kishte dalë në mal me Sadik Premten. Nga gjith turma e katundarve një zë u dëgjua pas fjalimit të Enverit: «Partia mbi të gjitha», Revolta e Sadik Premtes që n'atë çast kish mbaruar. Me parullën Partija mbi të gjitha, katundarët e Gjormit, Tragjasit dhe të Mesaplikut, nëpër gërxhe ndiqnin për të vrarë tradhtarin e Partisë dhe të popullit Sadik Premten, i cili mbaroi agjent i Simit dhe i Gestapos.

Gjatë këtyre lëvizjeve të tij dhe sidomos gjatë qëndrimit në Tiranë janë të panumurta episodet që i kanë ndodhur Enverit, por ka disa për të cilat ay mban kujtimin më të shtrenjtë. Në kodrën e Kuqe në Tiranë, me një shtëpi të vjetër prej qerpiçi banonte ilegalisht Vojo Kushi, Xhoxhi Martini që ishte i plagosur në një aksion, dhe Sadik Stavreleci, luftëtar i vendosur, por me trup të thyer prej tuberkulozi. Enveri kujdeset për jetën dhe shëndetin e shokve të tij. Ay ka mësuar se në shtëpinë ku banon Xhoxhi Martini i plagosur, shokët po bëjnë shumë lëvizje dhe se kjo bije në sy t'okupatorit. Ay nis vetë t'i japë fund kësaj gjëje. Ishte 12 orë para se të vriteshin. Aty takohet me shokët, heq vrejtjet për lëshimet që kanë bërë, i porosit kategorikisht të marrin masa mbrojtjeje, këshillon Xhoxhi Martinin të mbërthejë mekanizmën e kobures të tij njëzetshe me të cilën po lonte në duar. Sadik Stavreleci i jep udhëzime të ne-

sërmen të niset për Kosovë, i jep letrat dhe të hollat e udhtimit. Korierin e Partisë, që do të shkojë në Martanesh, për të çuar udhëzimet dhe material për çetën e Baba Fajës, e këshillon që të mos bëjë lëvizje dhe të ikë që pa gdhirë, të zonjës së shtëpisë një militante të vjetër, i urdhëron të mos të qasë më në shtëpi Anastas Lulon, i cili n'atë kohë ndodhej në Tiranë. Por pllani nuk doli dot në krye, të nesërmen që me natë forcat armike me mitroloza dhe me tankse kishin rrethuar shtëpin e Vojo Kushit. Lufta vazhdoi 6 orë me radhë dhe 6 orë të tëra Enveri nuk luajti nga dritarja e shtëpisë ku banonte 600 metro larg vendit të ngjarjes. Ay dëgjonte poteren e armëve dhe merrte me mënd se ç'dodhte, ay s'dinte kush luftonte, por sigurisht ishte luftë e shokve, që kish edukuar vetë. Atë ditë i prekur thellë nga vdekja e shokve të tij ay shkroi me dorën e vet traktin «Tri heroj», i cili u shpërnda për një herësh në popull.

Një herë tjetër ay ndodhej me shokun e tij të luftës Jugosllavin Miladin Popoviçin në një shtëpi puntori buzë Lanës. Shtëpia ishte e izoluar. Dy ditë më parë atje Enveri kishte nbaruar së shkruari traktin me rëndësi, që Komiteti Central u drejtonte katundarëve të Shqipërisë, i cili ishte shtypur në shtyp-shkronjat klandestine të qytetit dhe shpërndarë në gjith Shqipërinë. Ishte pra natë, dhe ishin vetë të dy, Enveri me Miladinin. Pa pritur

ndëgjohen armë dhe bomba, të shtirat u ndigjuan afër shtëpisë së Mustafa Krujës, e cila ndodhej atje afër. Të ipnin përshtypjen e një atentati. Pas armëve të para gjithë milicët që banonin në gazermat pranë shtëpisë së Mustafa Krujës, duke shtirë nga të katër anët lëshohen dhe rrethojnë mëhallën. Një burrë që banonte në katin e sipërmë të shtëpisë, ku ishte Enveri me Miladinin filloi të zbrazë armët nga dritarja. Puna u pa, ishte edhe ai një spiun. Të dy shokët u gjetën para vdekjes dhe me bomba në dorë ata prisnin momentin decisiv të sulmit. Në këtë moment suprem të jetës së tyre ata përqaftuan shoqi shoqin dhe Enveri kur flet për Miladinin, s'mungon të thotë fjalët e tij që ai i tha Enverit n'errësirën e asaj nate që i priste vdekja: «Shoku Enver luftuam dhe do të vdesim duke luftuar për një çështje të madhe, për çlirimin e Shqipërisë. Unë jam i lumtur që jap jetën për popullin Shqiptar. Gjaku i jonë le të shërbejë për vllazërimin e popujve t'onë». Dhe Enveri shton: «Kurrë në jetën e tij nuk e ka ndjerë vehten më të fortë se n'atë çast kur shihte se krahas me te një shok jugosllav kishte vendosur të vdiste me aq heroizëm për popullin Shqiptar». Fati e desh që këta të shpëtonin për qime.

Me Partinë dhe me Enverin në krye të punës e të përpjekjeve u përmbysnë njëra pas tjetrës tentativat e armikut për të shuar rezistencën e popullit, falimentuan

operacionet në shkallë të gjërë. terrori fashist, demagogjia dhe përpjekjet e armikut për krijimin e një baze politike dhe sociale në Shqipëri në favor të fashizmit. Me Partinë dhe me Enverit në krye populli i kuptoi çështjet shpejt, qëllimet e organizatave tradhtarë që u ngritën si reaksion kundër bashkimit dhe luftës së popullit për lirinë nacionale dhe për ngritjen e Pushtetit popullor. Fronti u zgjërua pa masë, lufta mori proporcione të mëdha, çeta të panumurta dhe batalione ishin ngritur në të katër anët e Shqipërisë, kryengritja e përgjithëshme e armatosur e popullit shkonte përpara. Në malet e Korçës Enveri inauguron Brigadën e I-rë, e cila u komandua prej Mehmet Shehut dhe shkrojti faqe të shkëlqyera në historinë e luftës s'onë. Pa u mbushur akoma 10 muaj nga konferenca historike e Pezës, më 10 Korrik 1943, kur forcat t'ona t'armatosura kishin kaluar nga formacione çetash në batalione me komandantë dhe komisarë të rregullt dhe ndihej nevoja për formë organizimi më të përshtatëshme, Enveri i ngarkuar nga Komiteti Central i Partisë shtron përpara delegatëve në Labinot çështjen e formimit të Shtabit të Përgjithshëm t'Ushtrisë N. Çl. Komisar politik i Shtabit emrohet Enver Hoxha. Vendimet u muar me unanimitet me përjashtim të Abaz Kupit, që kishte qëllime të tjera dhe programe të tjera, por që priste momentin e volitshëm për t'i shpallur. Në këtë konferencë u vendos që Ballit Kombëtar

t'i viheshin këmbët në një këpucë, si thotë populli i jonë. Ose të lëftonte okupatorin me armë, ose të merrte fund demogogjia e tij kriminale. Në konferencën e Mukjes disa të deleguar të Këshillit të Përgjithshëm Anti-Fashist kapitullojnë përpara reaksionit ballist. Ishte momenti, kur Italia fashiste kapitullonte. Enver Hoxha nga Vithkuqi lajmëron se është kundra pikpamjeve oportuniste të tyre dhe urdhëron ndalimin e bisedimeve. Nga ana tjetër Enveri thërret konferencën e II-të të Labinotit, ku marrin pjesë përfaqësuesit e Frontit N. Çl. të gjithë Shqipërisë dhe atje ai vetë demaskon politikën oportuniste të delegatëve të Frontit dhe t'Abaz Kupit që ishin dërguar si delegacion në Mukje. Konferenca aprovoi me unanimitet pikpamjen e Enverit dhe u vendos në atë konferencë lufta e pamëshirëshme kundra okupatorit dhe kundra Ballit Kombëtar dhe të gjithë atyre tradhtarve që do të pengonin ndërmarrjen e madhe. U muar gjith'ashtu vendimi që të thërritesh Abaz Kupi për të skjaruar pozitat e tij. Kjo barë i u ngarkua Enverit.

Në kapitullimin e Italisë dhe kur punët e konferencës kishin marrë fund Enveri shkon nga Labinoti në Pezë, afër Tiranës, për të organizuar batalionet. Por gjermanët që kanë marrë informata sulmojnë Pezën me fuqi të mëdha. Enver Hoxha mer pjesë vetë në luftën që zhvillohet në Arbanë kundër Gjermanëve. Gjermanët thyhen, atje gjen vdekjen dhe nipi i Herman Geringut.

Por gjermanët nuk heqin dorë nga operacione të tjera me stil të gjërë. Në të gjitha anët e Shqipërisë Ushtria N. Çl. nën urdhërat e Shtabit të Përgjithshëm është hequr në sulm, çliron qytete dhe krahina të gjëra dhe godit formacionet gjermane që tentojnë të sigurojnë pozitat e tyre në Shqipëri. Enveri organizon në Pezë Brigadën e III-të q'e inauguron aksionin e saj të parë duke qëlluar me top nga kodrat e Saukut pallatin e Luogotenentit mbi kodrat e Tiranës, ku ishte mbledhur, me inisjativën e gestapos, Asambleja e tradhtarve, nga ku do të dilte Regjenca kuislinge.

Nga Peza Enveri hidhet në Çermënikë dhe nga Çermenika në Shën-Gjergj të Tiranës për t'organizuar Brigadën e II-të t'ushtris N. Çl. dhe për të biseduar me Abaz Kupin. Kur ushtria N. Çl. luftonte okupatorin e ri gjerman, Abas Kupa i shtyrë prej gjermanëve dhe prej miqve të tij oficerave Englezë që qëndronin me të, konvokoi mbledhjen e Zallit Herit ku një grusht spiu-nash njëri-tjetri të Zogut, t'Italisë fashiste, të regjencës kuislinge, proklamuan Legalitetin. Në këtë mbledhje asistonte dhe oficeri i ndërlidhjes Englez. Manevra e reaksionit ishte e kuartë: Balli Kombëtar kishte humbur çdo kredi në popull, bandat e saj kishin zënë vendin e milicisë fashiste në duart e gestapos gjermane. Gestapua nën një flamur të ri kërkonte të grumbullonte reaksionin në luftë kundra partizanëve dhe nga ana tjetër reaksioni

Anglo-Amerikan përpiqesh të forconte pozitat e reaksionit në Shqipëri për të penguar hovin e math të lëvizjes çlirimtare dhe për të pasur më vonë mbështetje të fortë. Por këto plane të reaksionit dështuan si më parë. Abaz Kupi vjen në Shën-Gjergj dhe bisedon me Enver Hoxhën. Abaz Kupi kujtonte se do të kërcënonte lëvizjen me qëndrimin e tij që jashtë Frontit. Taktika e tij, që i a kishin mësuar englezët, ishte gati po ajo e Ballit: ay thosh, Fronti N. Çl. nuk është përveç se një maskë e Partisë Komuniste. Unë në Zall Herr formova Legalitetin, gjë që do të thotë se regjimi i Legalitetit, d. m. th. i Zogut, ekziston dhe është i vetmi regjim i popullit shqiptar, por regjimi i Zogut nuk do të jetë më regjim despotik por një regjim borgjez-demokratik, ku të gjitha Partitë do të jenë të lira etj. Prandaj Partija Komuniste nuk ka tjetër rrugë përveç se t'inkuadrohet ajo në Legalitetin. Abaz Kupi mori përgigjen e merituar. Fjalët e fundit që Enveri i tha Abaz Kupit, kur po ndaheshin ishin këto: «Ti s'ke bërë asnjë luftë kundra okupatorit, ti as në një moment nuk ishe i bindur dhe nuk mbajte fjalën që kishe dhënë, Fronti N. Çl. Fronti i gjithë popullit, do t'a vazhdojë dhe do t'a ashpërsojë luftën kundra okupatorit dhe tradhtarve. Në rast se ti do të luftosh kundër gjermanëve, jashtë Frontit N. Çl., sikundër që ti premton, atëhere unë ju siguroj se lufta do të na bashkojë dhe ti do të shohësh më kuartë se sa të

drejta janë fjalët t'ona, por të siguroj dhe një gje tjetër, në rast se ti do të na dalësh në rrugë, për të na penguar në luftën për çlirimin e popullit, ahëre ne do të te luftojmë pa mëshirë». Që prej asaj dite Abaz Kupi u qit jashtë Këshillit të Përgjithshëm N. Çl., jashtë shtabit të Përgjithshëm ku ay ishte vetëm formal. Ay u bë agjent i gjermanëve dhe vegla e reaksionit Anglo-Amerikan. Pas inaugurimit të Brigadës së II-të, Enveri pregatiti planin për një ofensivë kundër gjermanëve dhe reaksionarëve të vendit, në rrethet e Dajtit, të Çermenikës, të Dumresë, të Polisit me qëllim që të pastrohesh teneri dhe të kalonin forcat në rrethet e Korçës. Por në këtë kohë gjermanët filluan operacionin e math të dimrit, të ndihmaur nga forcat e Ballit Kombëtar dhe Legalitetit. Gjermanët sulmojnë me forca të mëdha qendrën e Shtabit të Përgjithshëm, Brigada e II-të pëson humbje, gjermanët dhe tradhtarët çajnë pozicionet, hyjnë në krahinat e çliruara, organizojnë reaksionin dhe sigurojnë të gjitha shtigjet. Enver Hoxha, bashkë me shokët e Shtabit, ndodhet i izoluar dhe i rrethuar nga gjermanët në zonën e Çermenikës. Ay kërkon një rrugë daljeje. Bora ishte e madhe, ay kapërçen pyjet e Martaneshit, detyrohet të kalojë ditë e natë në pyje dhe male me borë, të qëndrojë dit e net pa bukë dhe pa strehë. Kalon pyjet e Dibrës, por detyrohet të kthehet përsëri, pse shtigjet janë të pa-kalueshme nga bora

e madhe, nga gjermanët dhe nga kuislingat. Ay ishte i fortë dhe i duruar. Reziston me gjakftohësinë më të madhe. Qëndrimi i tij inkurajon shokët në momentet më tragjike. Vullneti i tij është vullneti i njeriut të ri, që s'e mundin vështirësitë, por i mund dhe fiton. Me një mijë mundime dhe me heroizmin e shokëve të tij katundarë ay organizon lidhjen, këthehet përsëri në malet e Çermenikës duke lënë në Martanesh Baba Fajën, i cili bije në përpjekje me gjermanët dhe çan rrethimin. Gjenerali Englez Dawis që ndodhet me Baba Fajën, u dorëzohet gjermanëve pa zbrazur pushkë. Enveri bën lidhjen me luftëtarët fshatarë, të cilët e strehojnë dhe e ruajnë si djalin e tyre. Gjermanët kanë filluar ofensivën e madhe kudo, por kudo gjejnë rezistencën e oshpër të forcave t'ona, që kanë ndihmën e popullit. Në luftë e sipër formohen Brigada të reja. Puna e kërkon Enverin në Jugë, pse atje është zjarri m'i math. Niset për në malet e Korçës, nëpër mjet reziqesh të mëdha, i veshur si fshatar dhe i shoqëruar prej fshatarësh. Ay kalon zona të tëra t'okupuara nga gjermanët dhe nga forcat e Ballit. Ay udhëton natën në borë e në tufan. Populli e pret kudo me dashuri, i bën vend me gjith zemër në kaso llën e tij dhe është gati të bëjë çdo sakrificë. Në një fshat të vogël të Verçës ay dhe shokët e tij gjenden në pozita shumë të vështira. Çetat balliste okupuan fshatin, ata u strehuan në të njëjtën shtëpi, ku

ishite fshehur Enveri me shokët e tij. Për të shpëtuar nga kjo situatë e vështirë, tërë ditën dhe tërë natën, me anën e një pioneri të vogël, të cilin e mësonte Enveri si të vepronte, ballistave u hyri paniku, se pioneri vinte e ju thosh se gjoja kishte dëgjuar që forcat partizane nën komandën e Mehmet Shehut po sulmonin atë krahinë. Heroizma e pionerit bëri që ballistat të largohehin me të shpejtë nga fshati dhe të hapesh rruga për Enverin dhe shokët e tij.

Gjatë dimrit, ay qëndroi në rrethet e Korçës, në luftë dhe në përpjekje me natyrën dhe me forcat gjermano-balliste, ay udhëzonte shokët, ay drejtonte Brigadat, drejtonte luftën. Pa hyrë mirë Prënvera, ofensiva e dimrit kishte dështuar, ushtria N. Çl. doli e pa-thyeshme. Por armiku që tash, po merrte masa për një ofensivë tjetër duke sjellë Divizione të regjura nga Greqija dhe duke mobilizuar të gjitha forcat e reaksionit. Por morali i popullit dhe i ushtrisë s'onë ishte shumë i lartë. Nga të gjitha anët vraponin me mijra vullnetarë të rinj në radhët e ushtrisë N. Çl. Lëvizja zgjerohej dhe situata kërkonte me urgjencë forma më të larta organizimi. U urdhërua nga Këshilli i Përgjithshëm Anti-fashist zgjedhje të përgjithëshme në të gjith Shqipërinë për delegatë që të vinin në Kongresin e Math të Përmetit. Më 24 Maj 1944 në Përmet mbledhet Kongres i I-rë anti-fashist. 200 delegatë afro kishin ardhur nga të gjith anët

e Shqipërisë. Enveri me eksperiencën e tij të madhe organizoi dhe drejtoi punimet e Kongresit. Në fjalimin e tij historik përpara delegatëve të Kongresit, ay dha një pasqyrë të studjuar dhe besnike të situatës së brendshme e ndërkombëtare dhe shtroi në mënyrë konkrete detyrat që i vihen përpara Kongresit. Nga Kongresi dolli Këshilli Anti-Fashist N. Çl. që zgjodhi nga gjiri i tij presidiumin dhe Presidiumi caktoi Komitetin Anti-fashist me artributet e Qeverisë Provizore. Kryetar i Komitetit emërohet Enver Hoxha, të cilit i besohet me brohoritje nga Kongresi Komanda e Përgjithëshme e Ushtrisë N. Çl. Në Kongresin e Përmetit u vendos përveç të tjerave krijimi i formacioneve të mëdha t'ushtris s'onë, dhënia e gradave n'ushtri, anulimi i të gjitha koncepteve, vendimeve, dhe mërëveshjeve, që kishin bërë qeveritë përpara 1939 ës me vëndet e huaja në kundërshtim me interesat e popullit, anulimi i të gjitha ligjeve, vendimeve dhe urdhërave të qeverive kuislinge, ndalimi i hyrjes së mbretit Zog në Shqipëri, gjersa populli të vendose vetë formën e regjimit, etj. Të gjitha këto u pritën me entuziazmë të madhe në popull, sepse provonin besnikërinë e udhëheqësve ndaj parimeve të luftës N. Çl. dhe shënonin rrugën për një t'arthme që s'e kishte gëzuar ndonjë herë poqulli Shqiptar.

Gjatë zhvillimit të Kongresit gjermanët kishin shpërthyer në të gjith Shqipërinë e Jugës, me fuqi të reja

ofensivën II-të, që u njoh më emërin ofensiva e Qershorit. Pas Kongresit Enveri me antarët e Shtabit dhe të Komitetit, i shoqëruar me pak partizanë kthehet në qendrën e Shtabit n'Odriçan. Ofensiva kaloi andej, gjermanët kaluan gjer afro 500 metra afër pyllit ku ishte Enveri. E gjithë popullata e asaj zone e dinte vëndin, por armiku s'e mesoi kurrë. Ofensiva e madhe e Qershorit që e përgatitur mirë, por ajo u thye, pse ajo gjeti rezistencën e ushtrisë heroike t'onë, që kishte tashti një orgonizim të shëndoshë. Brenda 20 ditve Brigadat dhe Divizionet t'ona i shpartalluan forcat armike, i hoqnë armikut inisjativën nga dora dhe filluan kundër ofensivën, e cila nuk u ndal gjer në çlirimin e Shqipërisë. Me urdhër të Komandantit të Përgjithshëm Divizioni i I-rë pas luftimesh të përgjakëshme me gjermanët dhe ballistat, ay mori inisjativën, kapërxeu Shkumbinin dhe ndiqte këmba këmbës gjermanët dhe kuislingat. Merçenarët e tradhëtorit Abaz Kupit tok me gjermanët u pritën rrugën reparteve të Divizionit të I rë. Brenda 1 ore forcat e Abaz Kupit u shkatërruan. Shtabi i Mezdheut i dërgonte ultimatumin Gjeneral Enver Hoxhës, që të pushonte luftën kundra Abaz Kupit. Ultimatumit u refuzua dhe trupat t'ona kaluan triumfalisht duke thyer kudo gjermanët dhe kuislingat, të cilët kishte filluar t'i mbronte hapët reaksioni Anglo-Amerikan. Forcat e Brigadës së V-të, që vepronin në Kukës, zunë të gjallë tradhtarin

e vjetër, trockistin tradhtar të popullit Zai Fundon, i cili ndodhej në Shtabin Kuisling të Kryezezve. Zai Fundua u gjykua dhe u pushkatua.

Me urdhër dite të Komandantit të Përgjithshëm, Ushtria N. Çl., që nëmëronte tashti Divizione dhe Korp-armata, u hodh n'ofensivë, për të çliruar qytete. Më 20 Tetor, kur pjesa më e madhe e Shqipërisë së Jugut dhe të Veriut ishin çliruar dhe forcat t'ona gjindeshin në dyert e Kryeqytetit, u mbledh në Berat mbledhja e II-të e Këshillit të përgjithshëm N. Çi. Enver Hoxha drejton punimet e Kongresit, ay mban raportin historik dhe përcakton detyrat për t'arthmen. Kongresi ndron Komitetin anti-fashist në Qeveri Demokratike të Shqipërisë, me Kryeministër Gjeneral Kolonel Enver Hoxhën, Merren vendime të rëndësishme për organizimin më të mirë të Pushtetit, shpallen të drejtat e qytetarit dhe të drejtat e barbarta të gruas me të burrit, merren masa për rindërtimin e vëndit të shkatruar nga lufta. Pas Kongresit Ushtria N. Çl., që drejtohet n'operacionet e saj prej Komandantit, i cili e ka shtabin në Berat, çliron Tiranën. Enveri, në krye të Qeveris dhe të Shtabit, hyn triumfalisht në kryeqytet më 28 Nëntor 1944. Populli i Tiranës që sapo ishte çliruar nga tmerrri i 19 ditë lufte me gjermanët brënda në qytet, kishte dalë i tërë përjashta për të pritur Enverin dhe shokët e tij që udhëhoqën luftën e çlirimit. Manifestimet ishin të mëdha. Nga tribuna

përpara hotel Dajtit, Enveri i foli për herë të parë drejt për drejt popullit të Tiranës dhe të gjith Shqipërisë. I gjith populli ndigjoi zërin e tij, ndëgjoi fjalën e tij, që ndiste dhe mobilizonte, që përshkruante heroizmat dhe sakrificat e popullit t'onë, që mbushte me kurajo dhe forconte zëmrat e lënduara, që zgjonte forcat e pashteruarara të popullit, i bashkonte dhe i drejtonte për në fitojre të reja. Po kishte një ton e një tërheqje fjala e Enverit, kishte një frymë lufte dhe mobilizim drejt së afërmes, që populli e kishte ndjerë dhe e kishte provuar edhe herë tjetër. Kishte frymën e artikujve të tij te Zërit Popullit, frymën e parullave dhe të trakteve më të përmëndura të Partisë Komuniste Shqiptare që populli i këndonte me shpirt, në dritën e zbetë të kandilit e nën terrorin më barbar t'okupatorit dhe q'atje, ay gjeti rrugën e çlirimit dhe të fitorjes. Fjala e Enverit ishte fjala e Partisë.

*
*
*

Nën udhëheqjen e Parsisë dhe të Enverit Shqipërija u çlirua, por ajo doli e shkatëruar nga lufta, me një ekonomi të dëmtuar rëndë dhe me pengesa të mëdha përpara. Armiqtë e brëndëshëm dhe reaksioni i jashtëm ishin gati dhe përgatiteshin që të përfitonin nga kjo situatë. Në kushtrimin dhe udhëheqjen e Enverit që e shpuri përmes konditave më të vështira në fitorjen e luftës s'armatosur, populli Shqiptar, me një herë pas çlirimit, me një heroizmë të pa shoqe dhe me një abnegaciou

të math, i u përvesh detyrave të reja, për rindërtimin e Atdheut, për organizimin më të mirë dhe forcimin e ekonomisë s'onë, për ngritjen e jetës politike dhe kulture të vëndit. Që me çlirimin e Shqipërisë duheshin spastruar ferrat. Gjyqet e popullit dënuan pa mëshirë kuislingat dhe tradhtarët. Fronti forcohesh dita dites. U ndërtuan në një kohë çuditërisht të shkurtër, rrugët, urat, fabrikat, të cilat u vunë në funksionim. U shtetzuan minjerat, u krijua sektori ekonomik i shtetit, u goditën pa mëshirë spekullatorët. U dekretua ligji i Reformës Agrare dhe kjo përfundoi me suksesin më të math. Bujqërit Shqiptarë muar tokat. U organizua dhe u formua aparat i Shtetnor i qendrës dhe i qarqeve, u forcua pushteti popullor i Këshillave, Ushtria Kombëtare Shqiptare hyri në rrugën e modernizimit. Më 2 Dhjetor u zhvilluan në Shqipëri zgjedhjet në mënyrë më demokratike për Asamblen Kombëtare. Nga çdo Prefekturë populli kërkoi Enverin të vërë kandidaturën në qarkun e tyre. Më shumë se 90% të zgjedhësve votuan për njerëzit e Frontit, për njerëzit e luftës N. Çl. Dhe njerëzit e luftës, Enveri dhe shokët e tij përfaqësues n'Asamblenë Popullore, më 11 Janar 1946 i dhanë popullit atë, që ishte aspirata m'e madhe e tij, realizuan ëndërrën e mijra dëshmorëve të luftës çlirimtare: Republikën Popullore të Shqipërisë, me statutin e saj nga më të përparuarit në botë.

Kur populli po ecënte me vendosmërinë më të madhe në rrugën e përparimit, mbeturinat e fashizmit, borqjezija reaksionare, çiflik-saibinjte, bejlerët, tregtarët e mëdhenj, kleri reaksionar katolik, të drejtuar nga agjentët e reaksionit Anglo-Amerikan, u përpoqën për shumë herë të pengonin punën e rindërtimit, të kurdisnin komplotte dhe atentate, të rëzonin regjimin popullor, të cop-tonin Shqipërinë, të pregatisnin një robëri tjetër të rëndë. Të gjitha këto u goditën pa mëshirë.

Besnik i parimeve të luftës N. Çl., populli që e don me gjithë zemër, ushtar besnik i Partisë, mbrojtës i miqësisë së sinqertë dhe i vllazërimit, që lidh popullin t'onë me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe të Jugosllavisë të Marshallit Tito, mbrojtës i miqësis së sinqertë me gjith popujt Demokratikë dhe i poqes së drejtë, Enver Hoxha është sot, si ishte dje në luftë, në krye të përpjekjes së madhe të popullit Shqiptar për ndërtimin e përgjithshëm t'Atdheut. Enver Hoxha është mbrojtësi i papërkulur i fitorjeve të popullit, i ashpër karshi atyre që kërkojnë të dëmtojnë popullin, ay është inspiratori dhe zbatonjësi më i vendosur i reformave të mëdha shoqërore, ekonomike dhe kulturele, që po e shpjen vëndin t'onë me siguri drejt një jete më të lumtur dhe më të përparuar.

